

University of Business and Technology in Kosovo
UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 10-2018

QENDËR KULTURORE

Burhan Mehmeti

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>

 Part of the Architecture Commons



Bartës Privat i Arsimit të Lartë
KOLEGJI UBT

Programi për Arkitekturë

QENDËR KULTURORE
Shkalla Bachelor

Burhan Mehmeti

Tetor / 2018
Prishtinë



Bartës Privat i Arsimit të Lartë
KOLEGJI UBT

Programi për Arkitekturë

Punim Diplome
Viti akademik 2014 – 2015

Burhan Mehmeti

QENDËR KULTURORE

Mentori: Dr. Arber Sadiki

Tetor / 2018

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Derisa vetëdijësimi i shoqërisë është segmenti më i rëndësishëm i çdo vendi, mbetet detyrë e përhershme e institucioneve kompetente që t'i thellojnë hulumtimet rreth dukurive të ndryshme që e shoqërojnë sistemin kulturor në vend. Në këtë kontekst, edhe punimi në vazhdim synon t'i identifikojë shkaqet kryesore dhe më me peshë që ndikojnë në ofrimin e ambienteve sa me komode për zhvillim të aktiviteteve kulturo-artistike, në mënyrë që të ndikohet në ndryshime pozitive në këtë aspekt. Bukuritë fizike të shqiptarit gërshetuar me ato të natyrës, ambientit ku ai jeton, qëndron e gjallëron përballë stuhive të shumta të jetës fuqizohen edhe me veshjet kombëtare që padyshim se janë ditari më i mirë që flasin për rrjedhën e jetës, historinë e bujshme shqiptare me të gjitha sfidat.

Kështu që nga vëzhgimet, bisedat, pyetësi dhe anketat e ndryshme të bëra në komunën e Gjilanit janë identifikuar brenga nga ana e shoqërisë duke përfshirë grupe të ndryshme si artistët, shoqërinë civile, shoqatat e ndryshme kulturore për mungesë të hapësirave për ta treguar veten aftesitë dhe të arriturat në përgjithësi probleme këto për të cilat trajtohet edhe kjo tematikë, ndër të tjera, që teknologjia me në qendër kulturën promovon nivel të lartë të të menduarit. Ky dokument thekson se përdorimi i teknologjisë në organizimin dhe manifestimin e ngjarjeve historike kulturore e artistike e bën procesin më efektiv dhe më atraktiv kur zhvillohet sipas metodologjive të përshtatshme e të avancuara duke rritur ndjeshëm kështu, si ndikimin e saj pozitiv edhe rezultatet në të formuarit e një shoqërie artdashëse. Në kuadër të kësaj, *marrja me trashëgimi nënkupton tri kushte thelbësore : Njohje, Profesionalizëm dhe Pasion* [1].

MIRËNJOHJE

Me kënaqësinë më të madhe shpreh falenderimet e mia të sinqerta dhe mirënjohje të veçantë për të gjithë stafin e UBT, në veqanti profesorët e departamentit të Arkitekturës për punën e palodhur dhe njohuritë që kanë transmetuar tek unë duke bërë të mundur rritjen e kapaciteteve të mia, përmirësimin e njohurive dhe zbatimin e tyre. Falederoj gjithashtu familjen time për mbështetjen morale dhe financiare që më ndihmuan në vazhdimin e studimeve dhe perkrahjen e vazhdueshme që më japin në të gjitha qellimet e mia pozitive.

Gjithashtu falenderoj kolegët për bashkpunimin dhe sidomos për ndihmën e tyre përgjatë tre viteve të studimeve së bashku.

Së fundmi, mirënjohje dhe falënderim shpreh për udhëheqësin tim shkencor Dr.Arber Sadiki, për punën e tij të palodhshme për të qenë gjithnjë në shërbim të studentëve , e sidomos për kohën, durimin, mirëkuptimin dhe mbështetjen e tij ndaj meje, inkurajimin që i ka bërë punës sime,vëmendjen e kushtuar si dhe për profesionalizmin në trajtimin e kësaj tematike.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE	V
FJALORI I TERMAVE.....	VI
1 HYRJE.....	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	2
2.1 Historiku i zhvillimit te Objekteve Kulturore.....	2
2.2 Arkitektura si bartëse e kulturës	2
2.3 Periudhat e zhvillimi të trashëgimisë kulturore në rajonin e Gjilanit	3
2.4 Qendrat Kulturore si vazhdimësi e natyrshme e “bërthamës” së qytetit .	3
2.4.1 Komunikimi ndërmjet hapësirave ndërlidhëse.....	4
3 MUNGESA E QENDRËS KULTURORE NE QYTETIN E GJILANIT.....	5
4 METODOLOGJIA.....	6
4.1 Historiku i Gjilanit.....	6
4.1.1 Struktura urbane.....	7
4.1.2 Shprehja arkitektonike.....	7
4.2 Trashgimia e Gjilanit.....	8

5	KONCEPTUALIZIMI	9
5.1	Lokacioni	9
5.2	Gjenerimi i formës.....	10
5.2.1	Koncepti.....	10
5.2.2	Struktura.....	11
5.3	Ndriçimi dhe Ventilimi.....	12
6	EPILOGU	13
7	REFERENCAT.....	14
8	BIBLOGRAFIA.....	15

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Skema e komunikimit të hapësirave të Qendrës Kulturore.....	2
Figura 2. Lokacioni.....	4
Figura 3. Skica – Koncepti.....	5
Figura 4. Skica – Struktura.....	7
Figura 5. Skica – Akustika.....	8
Figura 6. Skica – Ndriçimi dhe Ventilimi natyrorë.....	8
Figura 7. Imazh Atmosferik.....	8

FJALORI I TERMAVE

Qendër kulturore - Një institucion i projektuar për hapësirat zhvilluese të ngjarjeve kulturore – artistike.

Trashëgimia kulturore - është pasuri e brezave, detyrim madhor i tyre kundrejt së shkuarës dhe së ardhmes, vijimësi materiale e çdo kombi.

Konfigurimi arkitektural – ka të bëjë me mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave dhe qarkullimit apo komunikimit.

Kompozicioni arkitektural - përfshirë vendosjen e elementeve në një tërësi në atë mënyrë që secili përfundon në vendin e duhur për të sendërtuar një tërësi të perbashket

Kultura: manifestimet kolektive të arriturave intelektuale të njerëzimit, materiale dhe jo-materiale, sikurse në art, letërsi, shkence dhe në tere jetën shpirtërore; mënyrë të jetesës, banimit, ndërveprimit social; veçanërisht e dokeve dhe zakoneve si dhe besimit të një grupi të njerëzve në një kohë dhe hapësirë të caktuar. P.sh.: Kultura Shqiptare; Kultura Kombëtare; Trashëgimia Kulturore etj.

HYRJE

Tema shtjellon trajtimin e Qendrës Kulturore si i tille objekt Hibrid ku perfshinë këto objekte: Amfiteater, Qendra tregtare, Muzeu, Galeria për ekspozita si ndërtime arkitektonike me karakteristika të arkitekturës moderne.

Nocioni Kulturë: manifestimet kolektive të të arriturave intelektuale të njerëzimit, materiale dhe jo-materiale, sikurse në art, letërsi, shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore; mënyrë të jetesës, banimit, ndërveprimit social; veçanërisht e dokeve dhe zakoneve si dhe besimit të një grupi të njerëzve në një kohë dhe hapësirë të caktuar. P.sh.: Kultura Shqiptare; Kultura Kombëtare; Trashëgimia Kulturore; Kultura e Lashtë; Kultura Muzikore; Kultura Gjuhësore; Kultura e Banimit; Kultura e Ushqimit; Vatra e Kulturës; Shtëpia e Kulturës; Pallati i Kulturës, etj. Origjina: nga Anglishtja e Mesme (tregon një pjesë toke të kultivuar); nga Frëngjishtja apo direkt nga Latinishtja cultura “rritje, kultivim”. P.sh.: Kultura e Arave; Kultura Perimore; Kultura e Grurit; Tokë nën Kulturë/ tokë e mbjellë. Qendrat Kulturore si ;Amfiteatror, Muzet, Sallat per ekspozita etj lindin nga nevojat objektive, shoqërore dhe ka një zhvillim e traditë mjaft të gjatë. Gjatë historisë ka pësuar ndryshime dhe është përkryer, kështu që puna e saj e sotme kulturo-artistike është metodike dhe e palnifikuar mirë. Duke analizuar varshmërinë e pandarë të objekteve kulturore në një qytet, kjo Studio promovon zhvillime më komplekse dhe multi-funksionale të Arkitekturës Kulturele, si kombinime HIBRIDE, urbane dhe arkitektonike dhe njëherit duke krijuar komplekse që do të shmangnin ndërtime të shumta e të veçanta si shpërdorim i resurseve, hapësirës për ndërtim në qytete, dhe si rrjedhojë do të promovonte strategji të qëndrueshme për zhvillim të arkitekturës kulturele dhe vet strukturës.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Historiku i zhvillimit të Objekteve Kulturore

Ndërtesat e domenit kulturor mbesin ende “skena” më premtuese ku arkitektet mund të shprehin dhe praktikojnë “ëndrrat” e tyre për fenomenin dhe rolin katalitik, reprezentativ e performativ të arkitekturës si arti dhe shkenca e ndërtimit. Qendrat Kulturore si vazhdimësi e natyrshme e “bërthamës” së qytetit, mbesin sot ndër hapësirat më eminente të aktiviteteve dhe ndërveprimeve sociale e kulturore, shfaqjeve dhe performancave, po ashtu këto qendra synojnë krijimin e hapësirave vibrante e sociopetale, hapësirave identifikuese për komunitetin, si dhe paraqesin njëkohësisht hapësira e objekte reprezentative të vet zhvillimit dhe vlerave urbane e arkitektonike... *kur Kultura e takon Arkitekturën = Arkitektura mishërohet me Kulturën dhe pasqyron Vlerat e saja të Pandara [2].*

2.2 Arkitektura si bartëse e Kulturës

Arkitektura + Kultura = Arkitektura për ngjarje Kulturore = Arkitektura Kulturale.
Hapësira ku zhvillohen ngjarje kulturore, sikurse muzetë e artit, operat, sallat koncertale, teatrot, amfiteatrot, libraritë, qendrat e komunitetit, akuariumet, parqet, memorialët, etj. Duke analizuar varshmërinë e pandarë të objekteve kulturore në një qytet, kjo Studio promovon zhvillime më komplekse dhe multi-funksionale të Arkitekturës Kulturale, si kombinime HIBRIDE, urbane dhe arkitektonike dhe njëherit duke krijuar komplekse që do të shmangnin ndërtime të shumta e të veçanta si shpërdorim i resurseve, hapësirës për ndërtim në qytete, dhe si rrjedhojë do të promovonte strategji të qëndrueshme për zhvillim të arkitekturës kulturale dhe vet strukturës urbane.

2.3 Periudhat e zhvillimi të trashëgimisë kulturore në rajonin e Gjilanit

Trashëgimia kulturore e Rajonit të Gjilanit përmbledh në vetë gjetjet dhe ndriçimet e deritashme, që nga prehistoria e deri në ditët tona.

Përmes gjurmëve e gjetjeve që nisnin me Nekropolin tumular të Llashticës, pastaj Kalanë e Pogragjes, si dhe kishat paleokristiane të Paldeces, Laçit, Reyhanes e Seçishtes, por edhe të Kishës së Shen Varvares në Kmetoc, Manastirin e Moçarit në Kamenicë dhe të Manastirit të Shen Mehilit në Buzovik të Vitise.

2.4 Qendrat Kulturore si vazhdimësi e natyrshme e “bërthamës” së qytetit

Gjilani si qytet i Republikës së Kosovës, në spektrin e gjerë të përfaqësimit të shoqërisë kosovare padyshim ka për detyrë edhe prezentimin shpirtërorë dhe kulturore të saj. Për një përfaqësim të denjë të kësaj komponenteje të rëndësishme të një shoqërie nevojitet një infrastrukturë solide ku format e ndryshme të shprehjes kulturore dhe artistike do të konkretizoheshin përmes gjinive të ndryshme të arteve performative dhe atyre pamore si: muzikë, operë, teatër, film, pikturë, skulpturë, art konceptual, etj. Duke pasur në konsideratë rrethanat shoqëror-ekonomike dhe politike të Kosovës që prej pas luftës së dytë botërore e veçanërisht ato të viteve 90-ta, këto objekte përgjithësisht kanë munguar duke transferuar aktivitetet e tilla nëpër ambiente të improvizuara të cilat ofronin pak mundësi për t'u shprehur në plotëni idetë dhe konceptet artistike dhe rrjedhimisht edhe për tu shijuar si të tilla nga audiencia dhe shikuesit. Fatkeqësisht, si pasojë e një periudhe relativisht të gjatë të improvizimeve të tilla, në një mënyrë ka bërë që edhe sot hapësira të tilla të improvizuara të merren si modele normale.

2.4.1 Komunikimi ndërmjet hapësirave ndërlidhëse

Rëndësia e komunikimit linar përmes hapësirave ndërlidhëse mundëson komunikim më të qartë përmes gjatësisë së koridoreve të brendshëm që na shpiejnë tek hapësirat e nevojshme shfrytëzuese. Faktor tjetër me rëndësi jetike është drita natyrale ajo duhet të jetë e pranishme në sasi dhe cilësi të ndryshme në varësi të qëllimit të hapësirës shfrytëzuese e gjithë kjo në varësi të pozitës gjeografike të objektit. Nuk do të ishte aq funksionale nëse hapësirat e brendshme nuk do të arrinin komunikim të mirëfilltë me hapësirat e jashtme meqenëse disa hapësira kërkojnë mundësi të komunikimit direkt me hapësirat e jashtme. Grupimi i të gjitha hapësirave tjera, përpos atyre kryesore si amfiteatri, sallat për ekspozita hapësirat e Muzeut për prezentimin e elementeve apo ekspozateve. Lidhje kjo që krijon ambiente të jashtme të sigurta për aktivitete sekondare. Ne **arkitekture** *“Çdo problem i dizajnit fillon me një përpjekje për të arritur “përshtatshmeri” në mes të dy entiteteve: formës dhe kontekstit të saj. Forma është zgjedhja e vet problemit të parashtruar; konteksti definonvet problemin”* - Christopher Alexander [3].




Foto 1. Skema e komunikimit të hapësirave të Qendrës Kulturore

3 MUNGESA E QENDRËS KULTURORE NË QYTETIN E GJILANIT

Ndërtimi i shoqërisë së dijes, është një nevojë për të gjitha vendet të cilat synojnë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik ,kulturore dhe social . Roli i arsimit dhe aftësisht profesional ,arsimit për të rritur dhe arsimit gjatë gjithëjetës është vendimtar në ndërtimin e një shoqërie të tillë.Sidoqoftë, fusha e kultures në Kosovë, vazhdon të jetë çështje debatesh, posaçërisht në rrafshin e permbushjes se nevojave per egzistim te numrit te mjaftueshem te objekteve a hapësirave kulturore per mbarevajtjen e proceseve kulturo – artistike me kushte dhe komoditet te nje niveli me te larte procese keto te synuara per tu zhvilluar sipas standardeve, ne permbushjen e kerkeseva per zhvillim me efektiv. “Mungesa e ambienteve reprezentuese në kundërshtim me kriteret e përcaktuara, mbi ngarkimi i hapësirave aktuale, mungesa e kushteve të nevojshme për punë janë duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e arritjes te sukseseve kulturore. Kemi mjaftueshëm strategji për zhvillimin e cultures ne vend, por çalojmë në implementimin e tyre.

4 METODOLOGJIA

4.1 Historiku i Gjilanit

Është një nga shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës. Është vendosur në fushën e Gjilanit gjegjësisht në jug-lindje të Kosovës në Anamoravë. Ndërsa Regjioni i Gjilanit ka një sipërfaqe prej 525 km katror dhe përbëhet nga 63 fshatra, ka pozitë të mirë gjeografike, relievin dhe faktorët klimatik që krijojnë mundësi për zhvillimin e një flore dhe faune të pasur. Në gastrën e quajtur Gavran ka ekzistuar edhe një vendbanim , emri i të cilit nuk dihet. Supozohet se është vendbanim i xehtarëve gjatë kohës së eksploatimit të të xehes në Gllamë. Sipas disa thënieve, thuhet se në fshatin Depcë, të Kosovës Lindore, ana e Preshevës ekzistonte si vendbanim Gjinaj, tani lagje. Këta kanë bërë tregëti me Novobërdën. Për të qenë më afër tregut, si dhe kushteve më të mira për jetë ata tërhiqen nga ai vendmbanim dhe vendosën në tritorin e sotëm të Gjilanit, i cili në at kohë ishte livadhe, por që ishte i përshtatshëm për bujqësi, sidomos për blegtori. Në bazë të këtyre e ka marrë edhe emrin. Në Defterin osman të vitit 1455, thuhet se ky vendbanim ka patur 41 shtëpi, ndërsa sipas defterit kadastral të vitit 1566-1974, kishte 38 shtëpi e 12 beqarë. Ky vendbanim përmendet edhe më vonë në dokumente të shkruara dhe nga udhë përshkrues të ndryshëm. Rreth emrit të tij ekzistojnë disa mendime. Disa thonë se emrin e ka marrë në bazë të një vendbanimi me emrin Gjinaj që ka qenë në afërsi të fshatit Depcë të komunës së Preshevës, por që atëherë i takonte Gjilanit. Një mendim tjetër thotë se një oficer otoman që ka qëndruar në këtë vendbanim paska qenë nga një Gjejlan, që qenka diku në Siri apo diku tjetër në Lindjen e mesme dhe e ka pagëzuar me këtë emër, ndërsa mendimi më real qëndron në faktin se në Gjilan, rreth vitit 1750 u vendosë familja Gjinolli, që këtu erdhi nga Artana (ish Novobërda), e që i takonte fisit Gjinaj, andaj edhe nga kjo familje (Bahti Beg Gjinolli) e mori edhe emrin. Qyteti i sotëm i Gjilanit u themelua nga pushtetmbajtësit e Kosovës Gjinollët, me prejardhje shqiptare , nga fshati Gjinaj i Lumës. Ata në shekullin e XVIII morën pushtetin në Kosovë duke përfshirë edhe Gjilanin, Bujanocin dhe Preshevën. Selia e tyre ka qenë Prishtina.

4.1.1 Struktura urbane

Gjilani për një kohë të gjatë ka qenë qendër e rëndësishme ekonomike, kulturore dhe e artizaneve në rajon. Duke marrë parasysh poziten e tij Gjilani nëpërmjet rrugëve magjistrale ndërlidhet me qendrat tjera. Rrjeti i mirë rrugor i siguron Gjilanit lidhje të mira si me fshatrat rreth tij ashtu edhe me qendrat tjera të Kosovës dhe regjionit. Me ndërtimin e rrugëve unazore është bërë zvogëlimi i qarkullimit në brendi të qytetit. Me projektin e Mobilitetit është parapa organizimi i trafikut urban të Gjilanit. Deri në filli të shekullit XIX nuk kemi shënime të sakta mbi strukturën dhe numrin e banorëve të vendbanimit të Gjilanit. Në vazhdimësi që nga themelimi dihet se Gjilani ka qenë i banuar nga popullsia shumicë shqiptare por ka pasur edhe serb, turq dhe rom. Në Gjilan dhe rrethinë ishin bërë ndryshime të mëdha etnike, si pasojë e lëvizjeve të mëdha të popullsisë së ikur nga viset e përfshira në luftërat ruso-turke (1877-78) dhe nga ardhja e muhaxhirëve të ndjekur nga pushteti serb.

4.1.2 Shprehja arkitektonike

Gjilani e ruan ndjenjën e shtresëzimit të larmishëm arkitektonik që percakton karakterin e tij dhe deshmon historinë e tij, duke përfshirë edhe ato ndryshime urbane, arkitektonike dhe silistike që i kanë shoqëruar ndryshimet politike dhe ideologjike. Para djegies së Gjilanit (1850) shtëpitë ishin të mbuluara me kashtë. Pas djegies, shtëpitë e reja u ndërtuan me qerpiç të quajtura “dollma” tip oriental i shtëpive të mbuluar me qeramidhe e çamte. Çarshia shtrihej prej Xhamisë (së Shehrižadës) në qendër e deri te Ura e Musë Kotorrit (Maskatarit). Dyqanet ishin afër njëri tjetrit dhe ngjante në një kasabave turke. Në atë kohë Gjinollët kishin shtëpi njëkatëshe me lëndë druri (çatmali) me dru-gdhendje të ndryshme dhe me pamje të bukur. Ndërtesa prej guri ishte Kulla afër Sarajit, që një herë shërbeu për mbrojtje e pastaj u shndërrua në sahat kullë dhe hamami. Xhaminë e vjetër (Atik Xhaminë) e kanë ngritur Gjinollët me material të sjellë nga Artana, kurse xhaminë e re (të Shehrižadës) e ka ngritur Halit Beu, në vitin 1910 kurse minarja i është ngritur në vitin 1921. Kjo xhami është dëmtuar rëndë nga tërmeti i vitit 2002 dhe u rrënua tërësisht dhe me donacione është ngritur e reja.

4.2 Trashëgimia e Gjilanit

Nga e tërë struktura dhe pasuria e pjesëve kostumore, te burrat fjala vjen, në kohën e sotme ruhet rrallë vetëm plisi i bardhë në kokë, ndërsa pjesët tjera as që mund të mendohen për veshjen aktive e të përditshme. Veshja popullore, ajo e moçmja, ose e traditës si pëlqehet të quhet, thuaja se është zhdukur fare. Veshja e mirëfilltë e traditës që mbahej përgjithësisht për gratë, sot mezi mbahet mend, madje vetëm nga ndonjë grua e moshuar. Si për çudi vetë gratë e moshuara e tregojnë disi si kujtesë, që ua kanë treguar prindërit e tyre, ose që e ka bartur dikush tjetër. Ismet Haziri (boksier), Muharrem Sahiti, (futbollist), Agim Latifi (boksier) Jeta dramatike në Gjilan ka filluar me vizitat që këtu i ka bërë teatri shëtitës i Perica Aleksiqit (Petre Përliçko), para vitit 1940, ndërsa shfaqja e parë shqipe ka qenë “Vllazni interes” të Kristo Floqit, e shfaqur të dielën, më 26 mars të vitit 1943, nga arsimtarët shqiptarë të shkollës së përzier “Bogdani” në Gjilan. Ndërtesa prej guri ishte Kulla afër Sarajit, që një herë shërbeu për mbrojtje e pastaj u shndërrua në sahat kullë dhe hamami. Një dimension i veçantë i kësaj pasurie është edhe bashkëjetesa dhe harmonia mes besimeve të ndryshme fetare, element që i jep ngjyrë të veçantë karakterit shumëkulturor të qytetarëve.

5 KONCEPTUALIZIMI

5.1 Lokacioni per Qendër Kulturore

Pas qershorit 1999 deri në fillim të vitit 2007, në kazermën e ish APJ-së ishin vendosur trupat paqeruajtëse amerikane duke e shndërruar atë vend në kampin “Montith”, por që ata ishin zgjeruar dhe për këtë kamp, kishin përdorur përveç kazermës ekzistuese edhe pronat private përreth. Por, pas vitit 2007, prej aty janë tërhequr edhe forcat e KFOR-it amerikane për tu vendosur në kampin “Bondstill” të Sojevës së Ferizajt, ndërkohë që tani forcat e FSK-së janë vendosur në kazermë, ndërsa pronat përreth saj që ishin shfrytëzuar nga KFOR-i amerikan, janë lënë të lira. Sipas Planit Zhvillimor Urban të Gjilanit është parapare të ndërtohen objekte kulturore në kampin Montith si pjesë ndërlidhëse mes qytetit dhe fshatrave perçjellese lokacion ky në zhvillim e sipër duke synuar epitetin qyteze, arsye këto që ndikojnë në nevojat shtese për objekte kulturore, shëndetsore etj. Qendra Kulturore tenton që të ju përshtatet këtyre koncepteve të lidhjes së pjesëve të tjera të qytetit. Sa i përket qarkullimit të automjeteve është parapare që të jete po ai qarkullim normal mirpo për të ju evituar tollovide në qarkullim dhe ruajtjes së ambientit.



Figura 2. Lokacioni i objektit për Qendër Kulturore

5.2 Gjenerimi i formës

5.2.1 Koncepti

Eksperiencia jonë për një hapësirë arkitektonike është fuqishëm e influencuar nga mënyra se si arrijmë deri te ajo hapësirë. Ne zakonisht ballafaqohemi me ndërtesa, lagje, qytet e kështu me radhe dhe lidhemi me ato mentalisht. Thëks i veqante bie ne rendesine e burimit te konceptit ne bashkeveprim me kontekstin. Objekti do jetë shumë atraktivë ku do të tërheqë shumë vizitorët duke u bërë zonë shumë e frekuentuar. Përmes menyrave kompozicionale dydimensionale te tilla si simetria, copezimi, bashkimi arrijme ne gjenerimin e formes si rrjedhoje e kontekstit. *Arkitektët gjithashtu kane miratuar strategji qe përdoren më shpesh në qepje rrobash, të tilla si shtypjnen, palosjen, pështjelljen dhe ngushtimin etj.*[4],




Figura 3. Skica - Koncepti

5.2.2 Struktura

Struktura si nje prej pjeseve kryesore te muzeut perveq vetis se saj konstruktive ne kete muze etnografik vihet ne pah edhe ne pjesen e jashtme me mjaft kreativitet dhe ne menyre ekspresive. Një ide është një strukturë mendore me të cilën ne e organizojmë, dhe i japin kuptim të përvojave dhe informacioneve të jashtme. Ne kontekst kemi struktura te ndryshme Në ditët e sotme poashtu janë te njohura *edhe idetë e frymëzuara nga modelet biologjike nëpërmjet qasjeve biomimetike në strukturat e reja teknike te përbëra nga materialet bazë të tekstileve teknike qe lejojë procese të prodhimit të krahasohen me ato të përdorura nga natyra* [5].



Figura 4. Struktura

5.3 Ndiriçimi - Ventilimi

Ndiriçimi në objekte kulturore sigurisht që është një prej gjërave primare që duhet përkushtuar dhe duhet marr me delikatesë. Ndiriçimi natyral përveq efektit vizuel ekspresiv ka një rol shumë funksional dhe mjaft të pershtatshëm. Tek secila hapësirë, sallë ekspozimi egziston sasi e mjaftueshme e dritës indirekte që arrihet nga reflektimi i rrezeve të diellit mbrenda hapjeve të projektuara. *Hapjet në mënyrë horizontale dhe vertikale mundesojnë që rrezja në kënd të caktuar që vjen nga dielli të reflektohet shumë her për të kaluar si shumë e pershtatshme për nxenesit* [6]. Në pjesët e amfiteatros është paraparë ndiriçim natyral vetëm në anet ku nuk pengon ndiriçimi për shkak të eliminimit të problemeve me intensitetin jo të njetratshëm të dritës.




Figura 5. Akustika




Figura 6. Ndiriçimi dhe Ventilimi natyral

6 EPILOGU

Qendra Kulturore së bashku me ndikimet e jashtme arkitektonike dhe atyre të brendshme arrin të reflektoj atë se për qka edhe ka filluar të projektohet. Shtrirja së bashku me kontekstin dhe akset e levizjeve bën që kjo Qendër të jetë një përvojë e bukur për vizitorët dhe njerëzit që kalojnë përreth saj e sidomos ata të cilët e përjetojnë edhe hapësirën e brendshme. Mund të interpretohet se shprehja karakteristike arkitektonike e objektit hibrid me strukture, funksion, ndriçim, ekspresion reflektojnë gjenerimin e formave të nxjerrura nga vetë lokacioni të cilat janë si një thurje e njëtrajtshme dhe në harmoni me kontekstin. Problemi për të menduarit kreativ është ``të menduarit në lidhje me të menduarit``. Te menduarit lidhet drejtpërdrejt edhe me idenë logjike për gjithë projektin. *Zgjidhja duhet bazuar gjithnjë duke menduar për një kontekst me të madh; si një karrike në një dhomë, një dhomë në një shtëpi, një shtëpi në një mjedis dhe një mjedis në një plan të qytetit* - Eliel Saarinen [7]



Figura 7. Imazh Atmosferik

REFERENCAT

- [1] Edi Shukriu, 2011, Trashegima kulturore e kosoves -Vlerat sfidat dhe mundesite ,academia.edu, fq.2-5.
- [2] cand.Dr. Banush Shyqeriu M.Arch, Studio Dizajn 2b, Poetika e Formës dhe Hapësirës, fq.2.
- [3] Banush Shyqeriu, 2014, Ndertesat kulturore, Studio dizajn 2, fq 5.
- [4] Gwyn Miles, 2008, Parallel Practices in Fashion and Architecture , Exhibition guidebook, Embankment Galleries at Somerset House, fq 4.
- [5] Marcus Milwich, Thomas Speck, Olga Speck, Thomas Stegmaier dhe Heinrich Planck , 2006, Biomimetrics and technical textiles: Solving engineering problems with the help of nature`s wisdom, fq 4-11.
- [6] Alvar Aalto, 1995, Das Gesamtwerk - The Complete Work , , fq 45-62.
- [7] Matthew Frederick ,2007, 101 Things I Learned in Architecture School – fq. 185

BIBLOGRAFIA

All- about- light.org, Good Lighting for Museums, Galleries and Exhibitions

Crosbie, M.: Class Architecture. Images Publishing, Australia, 2006

Ursula Baus, Mike Schlaich – Footbridges ,Construction Design History

Folding Architecture, 2004

Atelier Joao Quintela Tim Simon, B.W.Knitter, Simon Burku – Berlin

STUDIO DIZAJN 2B – Dizajni, Projektimi dhe Zhvillimi i Ndërtesave

Kulturore

Muzeu i Kosovës, adaptuar nga Andrija Mutnjaković

Mimesis Museum, Paju Book City, South Korea; Alvaro Siza

“A Guide to Albanian Museums” Ministry of Tourism, Culture, Youth
and Sport, MTKRS dhe NVS Studio, Tirana 2006